



AGJENCIONI
PËR FINANCIM
NË KOSOVË

Në bazë të nenit 17, paragrafit 1, 2, 3 dhe 6, të Ligjit Nr. 06/L085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si dhe Nenin 14. “Kompetencat” të Statutit të Agjencionit për Financim në Kosovë, Bordi i Drejtorëve të Agjencionit për Financim në Kosovë, fondacion me numër të regjistrit 5200065-3, me adresë në Rr. Lidhja e Prizrenit Nr. 1, Pejë, Kosovë (këtej e tutje referuar si “**AFK**”), miraton këtë:

POLITIKË PËR PRANIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË SINJALIZIMEVE SI DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	3
NENI 1 – QËLLIMI	3
NENI 2 – FUSHËVEPRIMI	3
NENI 3 – PËRKUFIZIMET	3
KAPITULLI II – PARIMET E PROCEDURËS	4
NENI 4 – KONFIDENCIALITETI	4
NENI 5 – MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE.....	5
NENI 6 – PARIMI ZERO TOLERANCË DHE PROMOVIMI I SINJALIZIMIT.....	5
NENI 7 – PARIMI I MIRËBESIMIT	6
NENI 8 – VETËDIJESIMI I PUNONJËSVE	6
KAPITULLI III – ROLET DHE PËRGJEGJËSITË	6
NENI 9 – PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE VENDIMMARRËSE DHE ZYRTARIT PËRGJEGJËS	6
KAPITULLI IV – PROCEDURA E RAPORTIMIT DHE HETIMIT TË SINJALIZIMEVE	7
NENI 10 – INICIMI I PROCEDURËS SË SINJALIZIMIT – RAPORTIMI	7
NENI 11 – PRANIMI DHE EVIDENTIMI I SINJALIZIMIT	8
NENI 12 – PROCEDURA E HETIMIT TË SINJALIZIMIT	8
NENI 13 – PËRFUNDIMI I HETIMIT TË SINJALIZIMIT.....	9
NENI 14 – RASTET E KONFLIKTIT TË INTERESAVE.....	10
KAPITULLI V – MBROJTJA E SINJALIZUESVE	10
NENI 15 – TË DREJTAT E SINJALIZUESVE.....	10
NENI 16 – MBROJTJA E SINJALIZUESVE.....	10
KAPITULLI VI – DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	11
NENI 19 – MOS ZBATIMI I POLITIKËS SË SINJALIZIMIT	11
NENI 21 – HYRJA NË FUQI.....	11

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 1 – QËLLIMI

1. Qëllimi i kësaj Politike për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimeve si dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve (“**Politika e Sinjalizimit**”) është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimeve në kuadër të Agjencionit për Financim në Kosovë (“**AFK**”), si dhe për mbrojtjen e Sinjalizuesve.
2. Kjo Politikë e Sinjalizimit ofron një pasqyrë të qartë për të gjithë stafin e AFK-së mbi partimet kryesore të AFK-së në lidhje me sinjalizimin, procesin e hetimit dhe rolet dhe përgjegjësitë e ndryshme gjatë zhvillimit të këtij procesi.

NENI 2 – FUSHËVEPRIMI

1. Kjo Politikë e Sinjalizimit vlen për të gjithë të punësuarit të AFK-së, duke përfshirë por duke mos u limituar në të gjithë drejtorët, menaxherët e departamenteve, menaxherët e degëve dhe nëndegëve, oficerët, agjentët, stafin e përhershëm, punëtorët e përkohshëm, dhe/ose praktikantët.
2. Kjo Politikë e Sinjalizimit mbulon vetëm veprimet kundërligjore të përkufizuara me këtë Politikë. Çështjet rreth shkeljeve eventuale të të drejtave të një punonjësi ose ankesat personale për marrëdhënien e punës nuk mbulohen me këtë Politikë të Sinjalizimit.
3. Kjo Politikë e Sinjalizimit zbatohet kurdo, në të gjitha degët, rolet dhe nivelet e lartësisë së pozitave të punës.

NENI 3 – PËRKUFIZIMET

1. Për qëllim të kësaj Politike të Sinjalizimit, shprehjet e mëposhtme do të kenë këto kuptime:
 - 1.1. **Sinjalizim** - raportimin i informacionit për veprimet dhe mosveprimet e kryera në vendin e punës të cilat paraqesin kërcënim ose cenim të interesave të AFK-së;
 - 1.2. **Sinjalizues** - çdo punonjës i cili raporton informacione për një kërcënim ose cenim të interesave të AFK-së, të cilat jo domosdoshmërisht kanë efektet direkt apo personal për Sinjalizuesin;
 - 1.3. **Person i lidhur me Sinjalizuesin** - personi i cili ndihmon Sinjalizuesin ose mund të ofrojë prova të lidhura me sinjalizimin apo çdo person tjetër që mund të dëmtohet për shkak të çfarëdo lidhjeje me Sinjalizuesin;

- 1.4. **Veprim kundërligjor** - çdo veprim apo mosveprim i punonjësit me të cilin cenohen dispozitat ligjore në fuqi, qoftë në formë të veprës penale, apo kundërvajtjes. Këto veprime përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - 1.4.1. Korrupsioni
 - 1.4.2. Ryshfeti;
 - 1.4.3. Çdo veprim apo mosveprim i cili rezulton në rrjedhjen e informatave biznesore dhe / ose të të dhënave tjera konfidenciale ndaj palëve të paaautorizuara;
 - 1.4.4. Ushtrimi apo tentimi për ushtrim të ndikimit mbi një punonjës të AFK-së për të kryer veprim kundërligjor apo çfarëdo veprimi tjetër në dëm të interesave të AFK-së;
 - 1.4.5. Çdo veprim apo mosveprim tjetër i cili rezulton në shkelje të dispozitave ligjore në fuqi.
- 1.5. **Organet Vendimmarrëse**- organet e AFK-së të cilat vendosin për rastet e sinjalizimit, të cilat janë:
 - 1.5.1. Bordi i Drejtorëve, në lidhje sinjalizimet për Menaxhmentin e Lartë;
 - 1.5.2. Menaxhmenti i Lartë, në lidhje me sinjalizimet për të gjithë punonjësit tjerë të AFK-së me përjashtim të Menaxherëve të Lartë;
- 1.6. **Zyrtari Përgjegjës** - Udhëheqësi i Departmentit të Pajtueshmërisë, i cili bën pranimin e parë të sinjalizimeve dhe kryen trajtimin/hetimin e tyre;
- 1.7. **Zyrtar Ndhmës** - çdo zyrtar tjetër i AFK-së i cili mund të autorizohet gjatë procedurës së sinjalizimit për t'i ofruar ndihmë profesionale Zyrtarit Përgjegjës në zhvillimin e hetimit të sinjalizimit, duke përfshirë edhe vet Sinjalizuesin;
- 1.8. **Institucionet kompetente** - të gjitha organet ligjzbatuese, siç janë policia, prokuroria, gjykatat dhe çdo institucion tjetër kompetent për të trajtuar çështjet e sinjalizuara;
- 1.9. **Veprim i dëmshëm ndaj Sinjalizuesit** - çdo veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që cenon interesin e ligjshëm të Sinjalizuesit apo personit të lidhur me Sinjalizuesin;
- 1.10. **E dhënë personale** - çdo informacion lidhur me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm siç përcaktohet me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KAPITULLI II – PARIMET E PROCEDURËS

NENI 4 – KONFIDENCIALITETI

1. Organet Vendimmarrëse, Zyrtari Përgjegjës, si dhe çdo Zyrtar Ndhmës, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare duhet të ruajnë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale

informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë brenda ose jashtë AFK-së, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveç me pëlqimin me shkrim të Sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor që lidhet me:

- 1.1. hetimin efektiv të shkeljeve ligjore;
 - 1.2. parandalimin e rrezikut serioz për sigurinë e shtetit, shëndetin publik, sigurinë publike ose mjedisin;
 - 1.3. parandalimin e krimit ose ndjekjen penale;
 - 1.4. domosdoshmërinë e zbulimit në interes publik ose kur një gjë e tillë kërkohet me ligj.
2. Organet Vendimmarrëse, Zyrtari Përgjegjës, si dhe çdo Zyrtar Ndihmës, nuk duhet të njoftojnë personin e përmendur në sinjalizim, përveç nëse kërkohet domosdoshmërisht me ligj.
 3. Të dhënat ruhen në mënyrë elektronike dhe fizikisht të arritshme vetëm për Organet Vendimmarrëse dhe Zyrtarin Përgjegjës.
 4. Zyrtari Përgjegjës duhet të marrë pëlqimin me shkrim të Sinjalizuesit në rast se i kërkohet të japë të dhëna që mund të zbulojnë identitetin e Sinjalizuesit tek një autoritet kompetent për veprime që nuk mund të ndërmerren pa e zbuluar identitetin e Sinjalizuesit. Në rastet kur kërkohet me ligj të zbulohet identiteti i Sinjalizuesit, Zyrtari Përgjegjës njofton Sinjalizuesin për këtë fakt para si t'ia zbulojë identitetin.
 5. Përgjegjësia e konfidencialitetit është e zbatueshme edhe për çdo punonjës të AFK-së që mund të vihen në dijeni për informata që kanë të bëjnë me sinjalizimin, të pranuar qoftë me gojë apo me shkrim. Në rast se një punonjës ka pranuar ndonjë informatë të tillë konfidenciale, i njëjti duhet të lajmëroj menjëherë Zyrtarin Përgjegjës.

NENI 5 – MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

1. Të dhënat personale të Sinjalizuesit dhe të personave të tjerë të përfshirë në sinjalizim përpunohen vetëm për qëllime të kësaj Politike të Sinjalizimit dhe kufizohen vetëm deri në përfundimin e procedurës së sinjalizimit.
2. Organet Vendimmarrëse dhe Zyrtari Përgjegjës që marrin të dhëna personale sipas kësaj Politike të Sinjalizimit duhet t'i përpunojë ato në pajtim me Ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale në fuqi në Republikën e Kosovës.
3. Nëse gjatë trajtimit të informacionit të parashtruar nga Sinjalizuesi, haset në të dhëna personale që nuk janë relevante për rastin që është duke u trajtuar, Organet

Vendimmarrëse dhe Zyrtari Përgjegjës nuk mund t'i përpunojë më tutje të dhënat e tilla.

NENI 6 – PARIMI ZERO TOLERANCË DHE PROMOVIMI I SINJALIZIMIT

1. Gjatë punësimit apo angazhimit në AFK aplikohet parimi zero tolerancë ndaj veprimeve kundërligjore. Zero toleranca vlen për të gjithë punonjësit e AFK duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti i Lartë, deri tek secili punonjës tjetër i AFK pa marrë parasysh pozitën që e mbanë.
2. AFK promovon sinjalizimin dhe për këtë është e përkushtuar për të krijuar një kulturë të sigurtë, të hapur dhe transparente në vendin e punës, ku punonjësit inkurajohen të ngrenë shqetësimet sa më parë duke përdorur mekanizmat e vendosura me këtë Politikë të Sinjalizimit.

NENI 7 – PARIMI I MIRËBESIMIT

Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar. Nëse një Sinjalizues bënë një raportim në mirëbesim, por kjo nuk është konfirmuar nga procedura e hetimit, nuk do të ndërmerren masa kundër tij. Në marrjen e një raporti, Zyrtari Përgjegjës duhet të ushtroj kujdesin e duhur për të siguruar saktësinë e informacionit. Megjithatë, nëse Sinjalizuesi bënë një pretendim të rrejtshëm, me keqdashje apo qëllimshëm, për përfitime dhe arsye personale apo për t'i shkaktuar dëm punonjësve apo AFK-së, atëherë AFK mund të marrë parasysh masa disiplinore kundër tij/saj.

NENI 8 – VETËDIJESIMI I PUNONJËSVE

Punonjësit e AFK do të informohen për Politikën e Sinjalizimit për parandalimin veprimeve kundërligjore, pasojat që vijnë, dhe ku t'i adresojnë dyshimet për veprime kundërligjore. Ky informim do të bëhet qoftë përmes trajnimeve individuale apo përmes çfarëdo forme tjetër të trajnimit që Zyrtari Përgjegjës e sheh të arsyeshme. Këto trajnime do të ofrohen për të gjithë të punësuarit në intervale të rregullta vjetore nga Zyrtari Përgjegjës sipas udhëzimeve të Bordit të Drejtorëve.

KAPITULLI III – ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

NENI 9 – PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE VENDIMMARRËSE DHE ZYRTARIT PËRGJEGJËS

1. Përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve janë si në vijim:

- 1.1. është përgjegjës për sinjalizimet në lidhje me Menaxhmentin e Lartë;
- 1.2. emëron dhe shkarkon Zyrtarin Përgjegjës;
- 1.3. shqyrton raportin e Zyrtarit Përgjegjës mbi sinjalizimin e pranuar dhe të miratoj ose të refuzoj fillimin e hetimit nga Zyrtari Përgjegjës;
- 1.4. vendos lidhur me përfshirjen e Zyrtarëve Ndhmës në procedurën e hetimit të sinjalizimit;
- 1.5. shqyrton raportin vjetor të sinjalizimeve të pranuar dhe të trajtuara nga Zyrtari Përgjegjës dhe Menaxhmentit të Lartë për të gjitha rastet e sinjalizimit;
- 1.6. vendos për ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj Menaxhmentit të Lartë dhe/ose njoftimin e organeve kompetente mbi veprimet kundërligjore të tyre;
- 1.7. vendos për ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj Menaxhmentit të Lartë dhe Zyrtarit Përgjegjës, për çdo shkelje të kësaj Politike të Sinjalizimit;
- 1.8. autorizon organet kompetente të AFK-së për të ndërmarrë masa të menjëhershme për të parandaluar, penguar ose korrigjuar pasojat e dëmshme nga veprimi kundërligjor;
- 1.9. miraton këtë Politikë të Sinjalizimit dhe të gjitha ndryshimet e mëvonshme të saj;
- 1.10. çdo përgjegjësi tjetër që i takon Bordit të Drejtorëve sipas legjislacionit në fuqi.

2. Përgjegjësitë e Menaxhmentit të Lartë janë si në vijim:

- 2.1. është përgjegjës për sinjalizimet në lidhje me të gjithë punonjësit tjerë të AFK-së me përjashtim të Menaxherëve të Lartë;
- 2.2. shqyrton raportin e Zyrtarit Përgjegjës mbi sinjalizimin e pranuar dhe të miratoj ose të refuzoj fillimin e hetimit nga Zyrtari Përgjegjës; dhe
- 2.3. vendos për ndërmarrjen e masave disiplinore dhe/ose njoftimin e organeve kompetente;
- 2.4. në bashkëpunim me Zyrtarin Përgjegjës, përgatishin raportin vjetor për Bordin e Drejtorëve në lidhje me të gjitha sinjalizimet e pranuar dhe të trajtuara;
- 2.5. në bashkëpunim me Zyrtarin Përgjegjës, kujdeset për zbatimin efektiv të kësaj Politike të Sinjalizimit.

3. Përgjegjësitë e Zyrtarit Përgjegjës janë si në vijim:

- 3.1. pranon të gjitha rastet e sinjalizimit;
- 3.2. me autorizim të Bordit të Drejtorëve apo Menaxhmentit të Lartë, fillon dhe kryen hetimet mbi sinjalizimet e pranuar në bazë të rregullave dhe procedurave të kësaj Politike të Sinjalizimit;
- 3.3. komunikon me Zyrtarët Ndhmës për rastet e sinjalizimit në të cilat është kërkuar/autorizuar ndihma e tyre;
- 3.4. organizon trajnime të rregullta për të gjithë stafin e AFK-së në lidhje me rregullat dhe procedurat e sinjalizimit;

- 3.5. në bashkëpunim me Menaxhmentin e Lartë, përgatit raportin vjetor për Bordin e Drejtorëve në lidhje me të gjitha sinjalizimet e pranuar dhe të trajtuara;
- 3.6. në bashkëpunim me Menaxhmentin e Lartë, kujdeset për zbatimin efektiv të kësaj Politike të Sinjalizimit.

KAPITULLI IV – PROCEDURA E RAPORTIMIT DHE HETIMIT TË SINJALIZIMEVE

NENI 10 – INICIMI I PROCEDURËS SË SINJALIZIMIT – RAPORTIMI

1. Procedura e sinjalizimit iniciohet nga momenti i raportimit të informacionit tek Zyrtari Përgjegjës, në çdo kohë përmes:
 - 1.1. email-it, të qasshëm vetëm nga Zyrtari Përgjegjës dhe Bordi i Drejtorëve;
 - 1.2. zarfit të mbyllur dhe adresuar për Zyrtarin Përgjegjës;
 - 1.3. gojarisht, duke e raportuar tek Zyrtari Përgjegjës; dhe
 - 1.4. çfarëdo mjeti tjetër të përshtatshëm të komunikimit.
2. Informatat e sinjalizimit duhet të jenë të kuptueshme dhe duhet të përmbajnë të paktën të dhënat si më poshtë:
 - 2.1. të dhënat e personit/ave kundër të cilit paraqitet sinjalizimi;
 - 2.2. të dhënat e kontaktit të Sinjalizuesit, me përjashtim të rasteve kur sinjalizimi është anonim;
 - 2.3. përshkrimin e veprimit të dyshuar dhe të fakteve dhe rrethanave për të cilat është në dijeni Sinjalizuesi, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur.
3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim vetëm nëse në raportim janë shprehur qartë dhe janë të arsyeshme shkaqet e anonimitetit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar veprimin e dyshuar. Sinjalizimet anonime do të trajtohen në mënyrë të njëjtë sikurse sinjalizimet e rëndomta.
4. Sinjalizuesi mund të bëjë sinjalizim të jashtëm në Institucionet kompetente, në rastet kur bëhet fjalë për anëtarët e Bordit të Drejtorëve apo kur ka dyshime se procedura e sinjalizimit është e komprometuar.

NENI 11 – PRANIMI DHE EVIDENTIMI I SINJALIZIMIT

1. Zyrtari Përgjegjës evidenton sinjalizimin e pranuar dhe krijon një regjistër të posaçëm protokolli apo elektronik, i cili duhet të përmbajë:
 - 1.1. datën e pranimit;
 - 1.2. numrin e rastit;

- 1.3. të dhënat lidhur me Sinjalizuesin, me përjashtim të rasteve kur sinjalizimi është anonim; dhe
- 1.4. përmbajtjen e shkurtër të informatës.

2. Brenda 48 orëve, Zyrtari Përgjegjës i konfirmon Sinjalizuesit pranimin e informacionit dhe e njofton se trajtimi i tij do të zhvillohet sipas rregullave dhe procedurave të kësaj Politike të Sinjalizimit.

NENI 12 – PROCEDURA E HETIMIT TË SINJALIZIMIT

1. Brenda tre (3) ditë pune nga pranimit i sinjalizimit, Zyrtari Përgjegjës ka për detyrë që të përgatis një raport lidhur me detajet e sinjalizimit dhe t'i drejtohet Organit Vendimmarrës përkatës, varësisht nga lloji sinjalizimit siç është përcaktuar në nenin 9, me kërkesën për miratim të fillimit të hetimit.
2. Në kërkesën si në paragrafin 1, Zyrtari Përgjegjës ka për obligim që të jap mendimin e tij lidhur me bazueshmërinë e sinjalizimit, si dhe të propozoj përfshirjen e Zyrtatëve Ndihmës relevant për zhvillimin e hetimit.
3. Brenda dy (2) ditë pune, Organi Vendimmarrës përkatës jep miratimin ose refuzimin për fillim të hetimit të sinjalizimit.
4. Pas konfirmimit / autorizimit nga Organi Vendimmarrës përkatës, Zyrtari Përgjegjës fillon hetimin dhe shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga Sinjalizuesi. Gjatë fazës së hetimit, Zyrtari Përgjegjës mund të kërkojë informacion shtesë dhe dokumente relevante, të urdhërojë inspektime ose të marrë deklaratë nga personat në dijeni për çështjen, si dhe të konsultohet apo të kërkojë asistencën e Zyrtarëve Ndihmës.
5. Zyrtari Përgjegjës obligohet të dokumentoj me shkrim çdo veprim që kryen gjatë hetimit dhe të regjistroj çdo provë të paraqitur nga palët dhe të arsyetoj vendimin e mospranimit të tyre nëse vlerëson se prova e paraqitur nuk ka vlerë për çështjen.
6. Faza e hetimit nga Zyrtari Përgjegjës mund të zgjasë deri në njëzet (20) ditë nga data e pranimit të miratimit për fillim të hetimit të sinjalizimit.

NENI 13 – PËRFUNDIMI I HETIMIT TË SINJALIZIMIT

1. Zyrtari Përgjegjës, pas mbledhjes së të gjitha fakteve, provave dhe të gjeturave gjatë fazës së hetimit, kompletion dosjen dhe të njejtën ia dorëzon Organit Vendimmarrës përkatës, i cili në afat prej pesë (5) ditë pune, shqyrton të gjeturat e Zyrtarit Përgjegjës.
2. Nëse rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje ligjore sipas ligjit, Organi Vendimmarrës përkatës autorizon organin kompetent brenda AFK-së për fillimin e procedurave disiplinore, dhe/apo

njofton Institucionet kompetente në rastet kur veprimet apo mosveprimet janë të asaj natyre që është e domosdoshme të raportohet tek Institucionet kompetente.

3. Procedura e hetimit të sinjalizimit përfundon sa më shpejt që është e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e pranimit të sinjalizimit. Në rastet kur nga rrethanat e rastit nevojitet shtyrja e afatit, procedura mund të zgjatet dhe të përfundoj në një afat prej dyzetepesë (45) ditë nga data e pranimit të sinjalizimit.
4. Pas përfundimit të procedurës së hetimit, Zyrtari Përgjegjës njofton Sinjalizuesin lidhur me përfundimin e procedurës, por duke mos shpalosur detaje lidhur me vendimin/et mbi personin/at të cilët kanë qenë subjekt i sinjalizimit, të cilat vendime përbëjnë informacion konfidencial.
5. I gjithë dokumentacioni i sinjalizimit është dokumentacion konfidencial i veçantë dhe i njëjti ruhet dhe asgjësohet sipas Politikave përkatëse të AFK-së.

NENI 14 – RASTET E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

1. Sinjalizuesi mund t'i drejtohet drejtpërdrejtë Bordit të Drejtorëve, në rastet kur:
 - 1.1. Sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se Zyrtari Përgjegjës, ose Menaxhmenti i Lartë, është ose mund të përfshihet në praktikën e dyshuar të sinjalizimit;
 - 1.2. Sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se Zyrtari Përgjegjës ose Menaxhmenti i Lartë, për shkak të çfarëdo marrëdhënie ose shoqërie me një person që është ose mund të jetë i përfshirë në çështjen e pretenduar në sinjalizim, nuk është personi i përshtatshëm për t'u informuar me sinjalizimin.
2. Në raste të tilla, Bordi i Drejtorëve autorizon Komitetin e Auditimit në kuadër të Bordit të Drejtorëve për të trajtuar sinjalizimin përkatës, në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë Politikë të Sinjalizimit.

KAPITULLI V – MBROJTJA E SINJALIZUESVE

NENI 15 – TË DREJTAT E SINJALIZUESVE

1. Sinjalizuesi ka të drejtën e:
 - 1.1. mbrojtjes së identitetit të tij gjatë procedurës së sinjalizimit;
 - 1.2. ruajtjen e fshehtësisë së burimit të informacionit të sinjalizuar;
 - 1.3. mbrojtjes kundër veprimeve të dëmshme.

2. Të drejtat e Sinjalizuesit garantohen gjatë dhe pas përfundimit të hetimit të sinjalizimit.

NENI 16 – MBROJTJA E SINJALIZUESVE

1. Sinjalizuesi që raporton ose shpalos informata në pajtim me dispozitat e kësaj Politike të Sinjalizimit, nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë disiplinore, me përjashtim të rasteve kur Sinjalizuesi bënë një pretendim të rrejshëm, me keqdashje apo qëllimshëm, për përfitime dhe arsye personale apo për t'i shkaktuar dëm punonjësve apo AFK-së.
2. Sinjalizuesi ka të drejtën e mbrojtjes sipas Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe kësaj Politike të Sinjalizimit, në rastet kur:
 - 2.1. raporton informacion, siç është përcaktuar me këtë Politikë të Sinjalizimit;
 - 2.2. me arsye beson se informacioni i raportuar apo i shpalosur është i vërtetë.
3. Sinjalizuesi mbrohet nga çdo veprim i dëmshëm i marrë ndaj tij nga AFK në lidhje me marrëdhënien e punës për shkak të sinjalizimit në pajtim me dispozitat e kësaj Politike të Sinjalizimit, dhe çdo veprim i dëmshëm ndaj Sinjalizuesit është i pavlefshëm.

KAPITULLI VI – DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

NENI 17 – MOS ZBATIMI I POLITIKËS SË SINJALIZIMIT

Çdo veprim apo mosveprim që është në shkejlje të kësaj Politike të Sinjalizimit mund të rezultoj në shqiptimin e masave disiplinore, në përputhje me politikat dhe procedurat përkatëse për shqiptimin e masave disiplinore.

NENI 18 – HYRJA NË FUQI

Kjo Politikë e Sinjalizimit hynë në fuqi 7 (shtatë) ditë pas miratimit të saj nga Bordi i Drejtorëve të Agjencionit për Financim në Kosovë.

Në emër të Bordit të Drejtorëve:

Prof. Dr. Edmond Beqiri _____
Kryetar i Bordit të Drejtorëve

Data: 24.02.2025